



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

GJIROKASTËR
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1671 Prot.

Gjirokaštër, më 06. 12. 2019

Lënda : Përcillet vendimi i Bordit të Administrimit për miratimin e kriterëve të punësimit për pozicionin "Sanitare" në Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokaštër.

REKTORIT TË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", PROF.DR.BEKTASH MEMA
ADMINISTRATORIT TË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", Z. SEMI GOLEMI

KËTU

KRYETAR

Dr. Merita Isaraj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

GJIROKASTËR
BORDI I ADMINISTRIMIT

VENDIM NR. 65

Në mbështetje të nenit 49 pika 1, gërma f, të Ligjit Nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", si dhe të shkresës së Administratorit të Universitetit me Nr. 1670 Prot., datë 06. 12. 2019 "*Përcillen për miratim kriteret e punësimit për pozicionin "Sanitare" pranë Drejtorisë së Shërbimeve Universitare*", Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 06. 12.2019,

V E N D O S I:

1. Të miratojë kriteret e punësimit për pozicionin "Sanitare" pranë Drejtorisë së Shërbimeve Universitare:

A. Të interesuarit për pozicionin e mësipërm duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Të ketë përvojë pune në grup;
2. Të ketë aftësi të mira komunikuese;
3. Të jetë shtetas shqiptar;
4. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
5. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
6. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
7. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.
8. Të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore, që nuk është shuar sipas ligjit;

B. Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesë me shrim për të aplikuar .
 2. Curriculum Vitae cv
 3. Fotokopje të kartës së identitetit;
 4. Raport mjeko-ligjor;
 5. Librezë pune
 6. Dëshmi penaliteti ose aplikim për marrjën e saj
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Dr. Merita Isaraj

